

Abstracts are translated in Albanian by: Elmedina Česko

Praktika jonë:

500 Ditët e Marrëdhënies me Objektin Primar

Lëndim apo Dhimbje?

Genovino Ferri

Abstrakti

Pasi të përcaktohet ndryshimin midis dhimbjes dhe lëndimit, autori e krahason atë binom me një tjetër paraqitje të një debati ndërkombëtar mbi psikoterapinë analitike - subjektivitetin dhe para-subjektivitetin. Ai vendos fokusin e krahasimit të atyre binomeve gjatë periudhës së marrëdhënies të objektit primar - 500 ditët e para të jetës së një personi, nga konceptimi (ngjizja) deri te shkëputja (largimi nga gjiri).

Janë dhënë një gamë të gjerë faktorësh - anatomik, fiziologjik, hormonal dhe citokimik, që mbështesin hipotezën se vetëdija për dhimbjen nuk është e nevojshme që shenjat të kenë të prera në kujtesën implicite të pavetëdijës trupore si bazë për vuajtjet e mundshme relacionale.

Fjalët kyçe: lëndim, dhimbje, marrëdhënia e objektit primar, ndërtrupore , memorja implicite.

Mbajtja e Tupit në Psikoterapi Trupore

Një Qasje Neurobiologjike e Indit Lidhor

Will Davis

Abstrakti

Psikoterapia e trupore është ndikuar fuqimisht nga kërkimet e gjera të neurologjisë. Derisa këto ndikime janë lehtësisht të justifikueshme, ka pasur njëkohësisht një ndikim të largimit nga trupi në një model të bazuar në mendje. Në të njëjtën kohë, hulumtimi në terapitë manuale të indit lidhor, dhe veçanërisht në pjesën fasciale, ka zbuluar se si dhe pse teknikat e bazuara në trup mund të kenë efekte kaq të thella tek pacienti. Në vazhdimësi, ky studim ka zbuluar një sistem të panjohur deri më tani të komunikimit midis tre sistemeve nervore dhe trupit, duke rezultuar në formulimin e një modeli më të integruar të trupit / mendjes. Do të theksoj lidhjet që janë në rritje midis indit lidhor (CT) dhe tre sistemeve nervore në trup dhe do të tregoj rolin që luan indi lidhor në këto lidhje. Qështja kryesore është *plasticiteti* i indit lidhor; pra aftësia e tij për t'u përshtatur dhe ripërshtatur ndaj ndryshimit të kushteve në nivel lokal dhe sistematik, të jashtëm dhe të brendshëm, si dhe fizik dhe emocional. Plasticiteti e indit lidhor qëndron në zemër të çdo terapie që përfshin ose lëvizjen ose prekjen. Ky është ndikimi biologjik, me fokus në trup i efektit të psikoterapisë trupore.

Fjalët kyçe: fasciale, Reich, interpretues, introspeksioni, plasticiteti, indi lidhor, sistemet nervore

Të jetuarit e Trupit si Vetëdije Bashkuese

Judith Blackstone

Abstrakti

Ky punim paraqet Procesin e Realizimit, një metodë e psikoterapisë trupore që përfshin një seri ushtrimesh të harmonizimit të brendshëm për të përjetuar vetëdijen unike si parim e kontaktit të thelluar me vet veten dhe me njerëzit e tjerë. Punimi përqendrohet kryesisht në kuptimshmërinë dhe lehtësimin e kësaj metode të mishërimit. Në Procesin e Realizimit, mishërimi shihet si përvojë e të qenurit i pranishëm kudo në trup, njëherësh si vetëdije unike. Kjo është një zhvendosje nga të qenurit i vetëdijshëm për trupin, në të jeturit e

trupit. Punimi përshkruan se si Procesi i Realizimit përdor mishërimin e vetëdijes unike për të shëruar deficitet në kontakt me veten dhe të tjerët dhe për të përsosur aftësitë e terapistit për empatinë. Njëkohësisht janë përfshirë përvojat e shkurtra që ndërlidhen me Procesin e Realizimit për të ilustruar këtë ndryshim.

***Fjalët kyçe:** mishërim, Procesi i Realizimit, psikoterapia trupore, vetëdija*

**Prekja dhe Rregullimi i Afektit
Integrimi Postural, Aftësitë e Traumës,
dhe Mjetet e Psikoterapisë e Orientuar në Trup**

Bernhard Schlage

Abstrakti

Bazuar në hulumtimet e reja neurofiziologjike, ky artikull eksploron sesi ndikon prekja në zona të ndryshme të trurit tone nëpërmes receptorëve nervor dhe si teknikat e ndryshme të prekjës mbështesin nevojën e klientit për rregullimin e afektit. Duke ndjekur qasjen e propozuar nga Allan Schore për rregullimin e afektit, ky artikull demonstroi se çfarë mbështet shprehjen emocionale të klientit dhe zhvillimin e reziliencës të një uni të brendshëm. Artikulli përshkruan se si duhet të punohet me ciklin e afektit me klientët e traumatizuar dhe në varësi të kësaj të kuptohet pragu i tolerancës për të mbështetur klientët që vuajn nga emocionet e theksuara dhe të dhimbjes, dhe me ato të cilët vuajn nga mungesa gjenerale e emocioneve.

***Fjalët kyçe:** Prekja dhe rregullimi i afektit, receptorët mekanik të lëkurës, diagramet e ciklit të afektit, pragu i tolerancës*

Puna e traumës

**Momenti i tanishëm, Trauma,
dhe Psikoterapia Somatike Relacionale**

Homayoun Shahri

Abstrakti

Në këtë artikull, unë do të diskutojnë se si jeta jetohet në kohën e tanishme, dhe se si kjo lidhet me të jetuarit e një jete të lumtur. Unë do t'ju tregoj se të jetosh në kohën e tanishme ka të bëjë me jetesën e mishëruar dhe lidhjen me trupin. Roli i traumës relacionale në të qenurit i shkëputur nga trupi shqyrtohet në vazhdimësi. Pjesët ku marrëdhëniet e hershme jo të këndshme të objektit ndikojn në pamundësinë për të jetuar në momentin aktual shqyrtohen nga këndvështrimet e teorisë së marrëdhënieve të objektit dhe të neuroshkencës. Është diskutuar edhe roli shëruese i objektit të mirë - që është terapeuti - si dhe teknikat e bazuar nga njohurit e psikoterapisë somatike relacionale, e që kjo mund të shkurtojë procesin terapeutik.

Fjalë kyçe: neuroshkencë, marrëdhënia e objektit, koha e tanishme, psikoterapi somatike relacionale, objektet kalimtare, trauma

Qasja ndërdisiplinore

**Korrespondenca Midis Fazave dhe Elementeve
në Proceset Transformuese dhe Shëruese
Të Ndikuara nga Metoda të Ndryshme Terapeutike**

Muriel Moreno Ojeda

Abstrakti

Ky punim krahason vëzhgimet e autores për proceset e transformimit dhe ndryshimit terapeutik tek vetja dhe klientët e saj. Nëntë faza u vëzhguan dhe u titulluan Sistemi EsenciArt: 9 Fazat e Transformimit. Pyetja e hulumtimit është: A ka faza dhe elemente të përbashkëta gjatë proceseve transformuese dhe shëruese të përfshira nga terapi apo metoda të ndryshme? Çfarë kanë të përbashkët, dhe cilat janë ndryshimet në mes tyre? Një studim me 21 pyetje u përdor në bazë të *9 fazave të vëzhguara nga autori*. Në studim morrën pjesë 155 praktikues nga 35 shtete dhe nga 32 terapi / modalitete. 120 pjesëmarrës ishin femra; 35 pjesëmarrës ishin meshkuj. Moshat varionin nga 18 në 74 vjeçar. Ekspertiza varionte nga ata me pa përvojë profesionale (studentë) deri në 40 vjet praktikues profesional. Këta pjesëmarrës klasifikuan punën e tyre nga njëra këto tre qasje: Qasja e Mendjes, Qasja e Trupit dhe Qasja Trup-Mendje. Rezultatet treguan se profesionistë nga modalitete dhe qasje të ndryshme identifikojnë dhe vlerësojnë fazat dhe elementet e përbashkëta në proceset transformuese dhe shëruese siç përshkruhet në Sistemin EsenciArt: 9 Fazat e Transformimit, me një korrelacion mesatar në 9 nga 10. Rezultatet treguan se Qasja Trup-Mendje ishte më e përafërt sistemit EsenciArt. Të gjithë profesionistët vlerësuan 9 fazat me një korrelacion mesatar që varionin nga 7.8 deri në 9.9. Analizat cilësore gjithashtu rezultuan në korrelacion duke theksuar rëndësinë e praktikuesve duke qenë të pranishëm / prezent, të lidhur, të respektueshëm, të besueshëm dhe të kujdesshëm – e që këto janë kushtet e duhura për të aktivizuar një proces të shërimit organik tek qeniet njerëzore.

Fjalët kyçe: psikoterapia trupore, ndryshimi terapeutik, terapia trupmendje, Sistemi EsenciArt, psikosomatika.

Abstracts are translated in Albanian by: Arber Zeka

**Psikoterapia trupore në dhomën e lojës:
Qasja somatike në punën me klientët fëmijë**

Jennifer L. Taylor

Prill 2019

Abstrakti

Ky punim propozon një model teorik të terapisë së lojës që ndërthur perspektivat e neurobiologjisë së zhvillimit me parimet e psikoterapisë trupore. Autori sugjeron që zbatimi aktual i parimeve të zhvillimit nervor në terpinë e lojës mund të forcohet nga ndërhyrjet somatike që nxisin integrimin midis trupit dhe mendjes së fëmijës në zhvillim. Temat e rregullimit, përshtatjes dhe ndër-konceptimit janë hulumtuar nga një gamë e gjere kërkimesh somatike dhe aplikimet terapeutike. Ky punim paraqet një qasje integruese, trans-teorike të përfshirjes së parimeve të psikoterapisë trupore në dhomën e lojërave.

Fjalët kyçe: psikoterapi e trupit, terapi lojërash, psikologji somatike, rregullim, harmonizim, përgjim

Etika Profesionale

**Zbatimi i Kodit të Etikës në EABP
në praktikën e përditshme
Prezantim nga Komiteti i Etikës të
Shoqatës Kombëtare Greke për Psikoterapi Trupore
Antigone Oreopoulou**

ABSTRAKTI

Gjatë katër viteve të fundit, Komiteti i Etikës i Shoqatës Greke për Psikoterapi Trupore (PESOPS) mbajti katër takime për anëtarët e saj. Ky artikull përshkruan takimin e parë të komitetit, të titulluar Komiteti i Etikës dhe Kodi: Çfarë duhet të dimë në praktikën e përditshme dhe lidh historinë e asaj që ndodhi prapa skenave që çuan në përfundime të vlefshme.

Fjalët kyçe: Kodi i Etikës, Komiteti i Etikës, EABP, PESOPS, punëtori etike.

**Investigimi i ÇSPT
gjatë Epidemisë së Coronavirusit**

Xiao-Ge Liu, Wen-Tian Li, Fang Xiong, Lian-Zhong Liu, Ulrich Sollmann

Citim:

Abstrakti

Qëllimi: Kemi hulumtuar për të kuptuar çrregullimin e stresit post-traumatik (PTSD) gjatë epidemisë së koronavirusit dhe faktorët e lidhur me ndikimin. Ne përpjekje për të siguruar më shumë bazë për shërbime të synuara për të përmirësuar kujdesin shëndetësor psikologjik publik.

Metodat: Nga platforma e ndihmës psikologjike e ngritur nga Qendra e Shëndetit Mendor Wuhan, kemi marr të dhëna të mostrës në internet të banorëve kinezë gjatë epidemisë së koronavirusit. Duke përdorur shkallën e vlerësimit për PTSD si mjet studimi dhe i kemi analizuar ato me SPSS.

Rezultatet: Janë mbledhur gjithsej 376 të dhëna. Shkalla e PTSD-së së publikut ishte 45,93 ± 17,32, shkalla pozitive e zbulimit ishte 63,56% dhe niveli i PTSD i rritur me luhatjet. Gjinia, niveli arsimor dhe vendndodhja e pjesëmarrësve ishin faktorët ndikues. Konkretisht, gratë, nivelet e arsimit të ulët dhe njerëzit në Wuhan kishin më shumë të ngjarë të kishin PTSD.

Konkluzione: Epidemia kishte një ndikim të madh në statusin psikologjik të njerëzve. Megjithëse epidemia në thelb është vënë nën kontroll, nivelet e PTSD nuk kanë rënë. Prandaj, është e nevojshme të sigurohet ndihmë psikologjike në kohë për njerëzit në nevojë, dhe t'i ndihmojë ata të përshtaten me jetën sa më shpejt të jetë e mundur.

Fjalët kyçe: COVID-19; çrregullimi i stresit post-traumatik; faktorët e ndikimit; ndryshimet kohore

Trajtimi i shkurtër me urgjencë

Propozimi Metodologjik për Ndërhyrjen e Psikologjisë Funktionale

Zbatuar gjatë Emergjencës së COVID-19

Enrica Pedrelli

ABSTRAKTI

Pandemia COVID-19 ka kërkuar ndërhyrje masive për të ofruar mbështetje psikologjike për popullatën botërore. Ky artikull paraqet një metodologji të zhvilluar për vite me përvojë dhe të zbatuar për popullatën italiane nga psikoterapistët e Shoqatës së Psikoterapisë Funktionale (SIF) për projektin e Ministrisë së Shëndetësisë të quajtur Shërbimi Psikologjik i Dëgjimit Falas. Numri kombëtar pa pagesë. Trajtimi i Shkurtër në Urgjencë (Pedrelli dhe Sozzi, 2016) sipas Psikologjisë Funktionale (Rispoli, 2004; 2016) bazohet në përvojën e viteve në diagnostikimin dhe trajtimin e stresit, e kombinuar me aftësitë e psikologjisë së urgjencës. Ajo tregon se sa thelbësore është të kesh aftësi psiko-trupore në trajtimin emergjent dhe se si ishte gjithashtu e mundur, madje edhe në një kontekst izolimi dhe largësie, të përdoren teknikat e orientuara drejt trupit. Psikologjia Funktionale i referohet përvojave që formojnë bazën për zhvillimin e aftësive tek secili prej nesh si Përvojat Themelore të Vetes (BES). Në një rast urgjence, ne mund të punojmë në BES për të rivendosur stabilitetin emocional dhe sigurinë dhe për t'u rilidhur me burimet. Në këtë artikull, BES e Kontrollit dhe Perceptimit janë përdorur si shembuj për të siguruar një pamje të punës së mundshme të urgjencës në distancë.

Fjalët kyçe: trajtim i shkurtër në urgjencë, Përvojat Themelore të Vetëvetit, Teknika Psikokorporeale, Psikologji Funktionale

Koha për transformim dhe krijimtari

Rubens Kignel

Abstrakte

Ideja e këtij artikulli është të hulumtojë, eksplorojë dhe propozojë një mënyrë të re për të parë dhe jetuar me fatkeqësitë e jetës njerëzore në mjedis dhe sistemin në tokë. Që nga fillimi

i jetës, shumë para jetës njerëzore, natyra na ka treguar përmes zhvillimit se si forma të ndryshme të jetës gjetën një mënyrë për të lidhur, përshtatur, përfshirë dhe përjashtuar atë që është e nevojshme për të mbajtur jetën gjallë.

Ne si qenie njerëzore mund të mësojmë me mijëra vjet përvojë jetësore, në drejtim të ekologjisë së njerëzve për të ruajtur jetën kudo që ekziston. Kështu që, përpiqem të tregoj se ajo që konsiderohet si papastërti mund të jetë sistemi nga i cili varet të jetojmë, si dhe duke bërë socializim me marrëdhëniet psikike njerëzore me mjedisin dhe midis nesh.

Fjalë kyçe: ambienti, natyra, komunikimi ekologjik, psikoterapia trupore, natyra dhe komunikimi, virusi, kërpudhat dhe bakteret, papastërtitë dhe pastërtitë midis nesh, psikoanaliza, Reich.

Psikoterapia trupore në të gjithë botën Zhvillimi i psikoterapisë trupore japoneze Yasuyo Kamikura

Abstrakti

Ky artikull synon të prezantojë zhvillimin e psikoterapisë trupore japoneze duke u përqëndruar në Dohsa-hou, një psikoterapi origjinale japoneze krijuar nga Gosaku Naruse. Së pari, ky artikull prezanton psikoterapinë në Japoni, përfshirë licencimin e psikoterapistëve klinikë dhe psikoterapinë kryesore në Japoni. Së dyti, ajo prezanton psikoterapinë trupore, psikoterapistë të shquar dhe pranimin e njerëzve të prekjes në Japoni, ndërsa krahason kulturat perëndimore dhe lindore dhe psikoterapinë. Përveç kësaj, artikulli tregon se si Dohsa-hou është zhvilluar në fushat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke praktikuar trajnimin Dohsa, dhe njerëzit me sëmundje mendore duke përdorur kliniken Dohsa-hou. Më tej, autori diskuton disa çështje si një terapist Dohsa-hou, tema aktuale në shëndetin mendor

japonez mes pandemisë COVID-19, të tilla si "disponimi, depresioni i sjellë nga stresi nga karantina" dhe "lodhja e karantinës", dhe mundësitë e përdorimit në internet. Dohsa-hou, së fundmi, bëhet një propozim për të ardhmen e psikoterapisë. Përhapja e Dohsa-hou do të jetë e rëndësishme për zhvillimin e psikoterapisë trupore në Japoni.

Fjalë kyçe: psikoterapi trupi, Japoni, Gosaku Naruse, Dohsa-hou, trajnim Dohsa, klinik Dohsa-hou